

---

## KONTRATË DHURIMI KUOTE

---

Sot, në Tiranë, më datë 12/01/2024 (dymijë e njezet e katër), në selinë e shoqërisë "Identico Dental Clinic" Shpk, palët e mëposhtme vendosën të lidhin këtë kontratë dhurimi.

**Z. Elidjon Gjergji**, shtetas shqiptar, lindur më 14.09.1987, në Libofshë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. Personal I70914016G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "**Dhuruesi**");  
dhe

**Znj. Stela Shytaj**, shtetase shqiptare, lindur më 08.08.1995 ne Ballsh, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me nr. personal J55808073A, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "**Pranuesi i Dhurimit**");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Dhuruesi dhe Pranuesi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

### MEQENËSE:

- Shoqëria "Identico Dental Clinic" Shpk është një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me NIPT M32314015H dhe me seli në Njësi Pasurie me numër 2/401/ND-N21, Zona Kadastrale Nr. 8150, Rruga "Qemal Stafa", Tiranë.
- Siç rezulton nga ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për të dhënat e Shoqërisë, Dhuruesi zoteron **70%** (shtatëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Dhuruesi i ka njoftuar Pranuesit dëshirën e tij për dhurimin e **5 %** (pesë për qind) nga kapitali që ai zoteron në shoqëri dhe Pranuesi ka pranuar të fitojë kuotën e zotëruar nga Dhuruesi në Shoqëri sipas parashikimeve të kësaj Kontrate;
- Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pasi transferimi i kuotave sipas kësaj Kontrate është miratuar sipas Vendimit bashkëlidhur të Ortakeve, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

**ATËHERË**, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

## Neni 1 Objekti

1.1 Dhuruesi i dhuron dhe Pranuesi pranon të fitojë pronësinë mbi 5 % të kapitalit që dhuruesi zotëron në kapitalin e shoqërisë "Identico Dental Clinic" Sh.p.k.

## Neni 2 Deklarimet dhe garancitë

2.1 Dhuruesi pranon se deklaratimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a. Dhuruesi ligjërisht e në momentin e nënshkrimit zotëron kuotën që do të transferohet sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t`i transferuar kuotat.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.
- c. Çdo deklaratim apo garanci e dhënë nga Dhuruesi sipas kësaj Kontrate nuk përmban gabime materiale.

2.2 Pranuesi pranon se deklaratimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a. Pranuesi ka tagra të plota për të pranuar kuotën nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi.

## Neni 3 Transferimi i të drejtave mbi kuotat

3.1 Pronësia e 5 % të kuotave të Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesi te Pranuesi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotes së Shoqërisë në favor të Pranuesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ortakët e shoqërisë janë:

- *Elidjon Gjergji bëhet zotërues i 1 (një) pjese e cila përfaqëson 65% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Identico Dental Clinic" Shpk.*
- *Gjergji Rexho bëhet zotërues i 1 (një) pjese e cila përfaqëson 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Identico Dental Clinic" Shpk.*
- *Alessandro Avicenna bëhet zotërues i 1 (një) pjese e cila përfaqëson 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Identico Dental Clinic" Shpk.*
- *Stela Shytaj bëhet zotëruese e 1 (një) pjese e cila përfaqëson 5% të kapitalit themeltar të shoqërisë "Identico Dental Clinic" Shpk.*

3.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotën në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.


#### Neni 4 Të ndryshme

- 4.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 4.2. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.3. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje origjinale dhe me vlerë të njëjtë provuese.

Kjo Kontratë pasi u lexua nga Palët dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve.

**DHURUESI**

**ELIDJON GJERGJI**



**PRANUESI**

**STELA SHYTAJ**

